



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:127949

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05431546

Ac.nr.2030/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. B. nga P., rr xxxxx të cilin e përfaqëson avokat A. Th. nga P, kundër të paditurës MPB, Policia e Kosovë, Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë për kompensimin e pagës dhe ushqimit gjatë punës, vlera e kontestit **3,200.70 euro**, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1226/2021, të datës 21.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më **05.03.2024** nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E THEMELTË, ankesa e të paditurës MPB, Policia e Kosovë, Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET PJESËRISHT** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, C.nr.1226/2021 i datës 21.02.2022, në pikën **I (parë)** të dispozitivit të tij sa i përket kërkesëpadisë për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e prezencës në punë-shujtës ditore dhe çështja tani gjykohet si në vijim:

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit M. B. nga P, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të kompenimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë-shujtës t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,605.00 euro (642 ditë X 2.5euro) duke llogaritur një ditë pune nga 2.5 euro si e pabazuar

III Pjesa tjetër e ankesës së të paditurës, MPB, Policia e Kosovë, Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë, **REFUZOHET E PA BAZUAR**, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1226/2021 i datës 21.02.2022, në pikën **I** lidhur pagesën e pagës së 13-të për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe pika **II** e dispozitivit sa i përket shpenzimeve të procedurës, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1226/2021 të datës 21.02.2022 ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditësit **M. B. nga Prizreni dhe DETYROHET** e paditura MPB, Policia e Kosovë, Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë që në emër të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019 dhe 2020 t'ia paguajë shumën në lartësi prej 1,595,70 euro (531,90 x 3), ndërsa në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqimin ditor-shujtën shumën e përgjithshme prej 1,605.00 euro (642 ditë x 2.5 euro) duke llogaritur një ditë pune nga 2.5 € respektivisht shumën e përgjithshme prej 3,200.70 euro me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga dita e data e parashtrimit të padisë (21.06.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura që t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 144 euro në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovtojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar apo që ta kthejë çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi ka ushtruar përgjegjeje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195, par.1, pika d) dhe e), në lidhje me nenin 200 dhe 201, pika d) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës, MPB, Policia e Kosovë, Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë është e pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se M. B., përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar A. Th, avokat nga Prizreni, me datë 21.06.2021 ka ushtar padi ndaj të paditurës MPB, Policia e Kosovë, Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë për kompensimin e pagës dhe ushqimit gjatë punës, vlera e kontestit 3,200.70 euro.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më datës 01.10.2021 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesë padinë me arsyetim të mungesës së mjeteve buxhetore ngase Ministria e Financave nuk ka aprovuar kërkesën e policisë për mjete buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve, pra për paga të 13 dhe shpenzime të ushqimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur seancë kryesore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1226/2021 të datës 21.02.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë si të themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimin, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura andaj ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t'ia shpërblejë (kompensojë) 3 (tri) paga mujore në shumën prej 531.90 euro për vitet 2018, 2019 dhe 2020 mbi bazën e vlerësimit të performancës dhe kompensimin për ushqimin ditor në shumën prej 1,605,00 euro duke llogaritur një ditë pune nga 2.5 euro për shkak se nga provat materiale vërtetohet fakti se paditësi për vitin 2018, 2019 dhe 2020 ka punuar 642 ditë pune. Vendimin e saj e bazoi në nenin 29 të udhëzimit administrativ. Në raport me kamatën vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës vendimin e bazoi në nenin 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të paditurës brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika b), g), j), k) dhe m), si dhe për zbatimin e së drejtës materiale vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit ditore për ditët e prezencës në punës-shujtës ditore për paditësin Musa Balaj dhe për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në këtë pjesë dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimin të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimin ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, e po ashtu nuk ka kundërtënie në mes arsyetimit të aktgjykimin dhe përmbajtjes së provave të administruara.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se kërkesëpadija e paditësve duhet të hudhet si e palejuar për shkak se nuk i kanë shtjerr mundësitë e ankesës brenda institucionit të të paditurës në kuptim të nenit 78 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës. Gjykata e Apelit thekson se e

drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund ti mohohet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se kompensimin e pagës së 13-të do ta bënin vetën në bazë të mundësive buxhetore të punëdhënësit ngase asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim ligjor, se me qëllim të sigurimit të mjeteve buxhetore për realizimin e kësaj pagese, Policia e Kosovës me datë 24.10.2017 përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme ka parashtruar kërkesë buxhetore sipas Qarkores Ref 2018/02 për periudhën 2018-2020 që të ndahet një shumë e caktuar e mjeteve për mbulimin e kërkesave të tilla, kërkesa e Policisë së Kosovës nuk është aprovuar nga ana e autoritetit miratues- Ministrisë së Financave. Këto pretendime e paditura nuk i ka mbështetur me asnjë provë konform nenit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së ku parashihet se *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, për më tepër çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 02/2018, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29 paragrafi 1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2 përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Paditësi i plotëson kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që është në marrëdhënie pune tek e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestueses, 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018, 2019, 2020 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje.

Sipas Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në Udhëzimin Administrativ numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 si dhe Udhëzimi Administrativ 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 i cili e ka shfuqizuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2018, mirëpo sipas kësaj gjykate, personeli i policisë kanë të drejtë që edhe për vitin 2021, të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e theksuara si më lartë, për arsye se neni 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri më datën 29.09.2021, dhe ka qenë i katakterit detyrues, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021, të planifikojë mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 213/2023 e datës 09.10.2023.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të LMD-së, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Mirëpo, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit Musa Balaj përkitazi me shpërblimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e prezencës në punë –shujtës ditore. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar, ngase me asnjë diospiozitet ligjore ligjore nuk parashihet një e drejtë e tillë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), në lidhje me nenin 200 dhe 201 pika (d) të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2030/2022, datë 05.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka